



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

Kuvendi i Kosovës

Duke u mbështetur në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, Kreu 1, Neni 1.2 dhe 1.4 dhe Kreu 9 , neni 1.26,

në Seancën Plenare të mbajtur më 22 dhjetor 2003, miratoi këtë

**D E K L A R A T Ë**

1. Kuvendi i Kosovës i deklaron jokushtetuese dhe të papranueshme zgjedhjet e organizuara nga Serbia në territorin e Kosovës, si provokim të rëndë për institucionet e Kosovës, qytetarët e saj dhe për institucionet ndërkombëtre në Kosovë;
2. Kuvendi i Kosovës kërkon nga UNMIK-u që t'i parandalojë organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, të cilat paraqesin ndërhyrje flagrante në jetën institucionale të Kosovës dhe tensionojnë raportet e përgjithshme në Kosovë;
3. Kuvendi i Kosovës i fton qytetarët e përkatësisë etnike serbe në Kosovë që të mos bëhën pre e manipulimeve dhe instrumentalizimeve negative politike të drejtuara jo vetëm kundër interesave të Kosovës, por edhe të interesave të vetë komunitetit serb në Kosovë.

Në Prishtinë  
Më 22 dhjetor 2003

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës**

**akademik Nexhat Daci**